



Nr. 21/1 prot

Dt. 31/05/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



Nr. Serial 000164

**LEJE**  
**PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR**

Nr. 202 Prot., datë 24/05/2022

Miratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. 16 , datë 20/05/2022

Emri i individit/subjektit:	“A-KORABI” sh.p.k
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT):	K97026701G
Baseni Ujor:	DRIN-BUNË
Qarku:	DIBËR
Bashkia/ Njësia administrative:	DIBËR/FUSHË-ÇIDHËN
Koordinatat:	X = 541848 Y = 4623006 Z = 1760 m
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji:	PËR UJË TË AMBALAZHUAR
Prurja mesatare vjetore	1.0 l/s
Prurja ekologjike	nuk ka
Sasia e ujit që jepet për përdorim	0.9 l/s
Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka)	nuk ka
Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer	nuk ka
Vendi i fabrikës së imbotilimit:	X = 531464 Y = 4624156 Z = 610 m
Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes):	nuk ka (ha)
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka):	Sipas Kushteve të lejes.
Periudha e vlefshmërisë:	5 Vjet
Hyrja në fuqi	Pas publikimit në Rregjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve

**KRYETARI**

**MAJLINDA ANGONI**



### **Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor**

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifaf në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujor për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo vepre marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Kjo leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes.
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit.
11. Të lejojë rrjedhën ekologjike, sipas specifikimeve në leje apo autorizim.
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor në rast të një aksidenti, apo incidenti.
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme.
14. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur.
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarinë të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.